



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mbikqyrje e objektit Rikonstrukcion Kanali Ujitës Rezervuari Qafë Thanë-Boqezë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbikqyrja e punes se ndertimit: 71247000-1

Sherbime te mbikqyrjes: 79714000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

148,423 (njëqind e dyzet e tetë mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë PA TVSH, me burim financimi nga “Buxheti i Shtetit”.

Perllogaritja e fondit limit eshte bere nga Specialisti I Fushes se D.P.K.ZH.T., Bashkia Pogradec, duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”..

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: 2 muaj Duke filluar nga nenshkrimi i kontrates deri ne perfundimin e plote te punimeve te zbatimit per kete objekt.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojme qe operatorët ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor të maturuara për vitin 2026 pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shenim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga OE të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojces 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nese do të jete nevoja per t'u kerkuar sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin Mbi Të Ardhurat”, të ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin shtetëror, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për kontrata të mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedurë prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kësaj kontrate, duhet të disponojë stafin teknik të shoqërisë, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier hidroteknik 1 (një)

-Për inxhinierin e mesipër të paraqitet:

- a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- b) Diplomë

-Inxhinieri te jete ne listepagesat e shoqerise per muajin e fundit nga dita e hapjes se ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri për stafin është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit te zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur per zbatimin e kesaj kontrate.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Stafi inxhinierik I kerkuar që do të realizojë mbikqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve, konkretisht nje inxhinier hidroteknik pasi ky inxhinier ka rezultuar nga zberthimi I zerave te punimeve ne objektin baze nderttimor.

2.3.3 Cdo operator ekonomik ofertues duhet te paraqese licensen profesionale te shoqerise per mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi, ku te perfshihen kategorite e meposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- | | | |
|-------|---|---|
| N.P - | 1 | Punime gërmimi në tokë. |
| NP – | 7 | Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje. |

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për liçencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për liçencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensë profesionale për “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, si dhe VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve qe do realizohen sipas preventivit dhe projektit te zbatimit. Kerkesa e disponimit te nje license te tille te leshuar nga ana e organeve kompetente eshte e lidhur ngushtesisht me tipologjine e sherbimit te kerkuar objekt kontrate si dhe elementeve te zerave te preventivit , ku jane zera te cilet jane te pasqyruar ne VKM nr 629 date 15.07.2015 ‘Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre’.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Në përgatitjen e ofertes, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me shkresën me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim.

Shenim: Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Vlera e punimeve për objektin: “Rikonstruksion Kanali Ujitës Rezervuari Qafë Thanë-Boqezë është 7,101,571. 98 (shtatë milion e njëqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

- Preventivi, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe projekti i zbatimit për objektin janë në SPE me nr. **REF-89754-06-11-2026**

Argumentimi: Është vendosur kjo kërkesë bazuar në njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, te ndryshuar si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si dhe VKM-se nr.610 date 22.09.2022 ‘Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve’’ si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”..

Perilogaritja e fondit limit eshte bere nga Specialisti I Fushes se D.P.K.ZH.T., Bashkia Pogradec.

NJËSIA E PROKURIMIT